



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Ndihma Juridike / Pravna Pomoć
Legal Aid

**AGJENCIA PËR NDIHMË JURIDIKE FALAS
AGENCIA ZA BESPLANTU PRAVNU POMOĆ
AGENCY FOR FREE LEGAL AID**

**Raporti Vjetor
Godišnji Izveštaj
Annual Report**

2013

PËRMBAJTJA

1. FJALA Hyrëse	3
1.1. Vizioni	5
1.2. Misioni	5
2. AGJENCIA PËR NDIHMË JURIDIKE FALAS	5
3. KËSHILLI PËR NDIHMË JURIDIKE FALAS	6
3.1. Përbërja e Këshillit për Ndhmë Juridike Falas	6
4. AKTIVITETET E ANJF-SË.....	7
5. ZYRA E DREJTORIT EKZEKUTIV.....	7
5.1. Aktivitetet e Zyrës se Drejtorit Ekzekutiv	8
5.1.1. Mësimi praktik.....	9
5.1.2. Takime të rëndësishme	9
5.1.3. Zyra e Administratës Qendrore.....	10
5.1.4. Burime Njerëzore.....	10
5.1.5. Trajnimet	10
5.1.6. Buxheti dhe financat	11
5.1.7. Prokurimi	13
5.1.8. Teknologji Informative.....	14
5.1.9. Arkiva	14
5.1.10. Auditimi.....	15
5.2. Zyrat Rajonale për Ndhmë Juridike Falas	16
5.2.1. Kompetencat dhe përgjegjësitë e ZRNJF-ve	16
5.2.2. Zyra Rajonale për Ndhmë Juridike Falas (ZRNJF) - P r i s h t i n ë.....	16
5.2.3. Zyra për Ndhmë Juridike Falas (ZRNJF) - P r i z r e n	18
5.2.4. Zyra për Ndhmë Juridike Falas (ZRNJF) - P e j ë	18
5.2.5. Zyra për Ndhmë Juridike Falas (ZRNJF) – M i t r o v i c ë.....	19
5.2.6. Zyra për Ndhmë Juridike Falas (ZRNJF) – G j i l a n.....	20
5.3. Struktura e Agjencisë për Ndhmë Juridike Falas	23
5.4. Bashkëpunimi ndërkombëtar.....	25
5.5. Bashkëpunimi i Agjencisë për Ndhmë Juridike Falas me Odën e Avokatëve të Kosovës (OAK).....	25
5.6. Donatorët	26
5.7. Mangësitë dhe sfidat në Sistemin e Ndhmës Juridike.....	26
5.8. Mangësitë në Sistemin e Ndhmës Juridike.....	26
5.9. Sfidat në Sistemin e Ndhmës Juridike	26
6. Rekomandime.....	28

1. Fjala hyrëse

Kemi nderin që para Jush të paraqesim Raportin e punës së Agjencisë për Ndhimë Juridike Falas (ANJF) për vitin 2013.

Përmbledhja e rezultateve të ANJF-së pasqyron kapacitetet dhe punën njëvjeçare, lidhur me përmbushjen e ofrimit të ndihmës juridike falas, në sistemin e drejtësisë në Republikën e Kosovës.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, ndihmën juridike e përcakton si kategori kushtetuese dhe sipas nenit 31 paragrafi 6, definohet se “Ndhimja juridike falas do t’u mundësohet atyre që nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare, nëse një ndihmë e tillë është e domosdoshme, për të siguruar qasje efektive në drejtësi”

Më 07 mars 2012 ka hyrë në fuqi Ligji nr.04/L-017 për Ndhimë juridike Falas, me te cilin rregullohet organizimi dhe funksionimi i ANJF-se.

Në këtë kuadër, është e rëndësishme të potencohet kapaciteti i ANJF-së, lidhur me mundësinë e përmbushjes së detyrimit për të siguruar ofrimin e ndihmës juridike falas. Sidomos, duke marr parasysh strukturat dhe mekanizmat ekzistues brenda ANJF-së, duke analizuar mundësinë për ngritjen e strukturave/mekanismave të reja, duke ngritur dhe forcuar kapacitetet e reja të burimeve njerëzore, si dhe instrumentet e bashkëpunimit në mes të ANJF-së dhe institucioneve tjera, posaçërisht atyre të përfshira në ofrimin e ndihmës juridike falas.

ANJF-a vazhdon të jetë institucioni më i rëndësishëm në sistemin e integruar të ndihmës juridike, në drejtim të ofrimit të ndihmës juridike falas. Numri dhe llojllojshmëria e kërkesave të shfrytëzuesve të ndihmës juridike, tregojnë nevojën dhe rëndësinë e qëndrueshmërisë së këtij institucioni.

Megjithatë ANJF-ja në arritjen e objektivave është ballafaquar me sfida të konsiderueshme, ne rend te pare mungesa e buxhetit, për shtrirjen e ndihmës juridike ne tere territorin e Republikës se Kosovës ne pajtim me Ligjin për Ndhimë Juridike Falas.

Ky Ligj rregullon krijimin e një sistemi funksional për ndihmë juridike falas, në procedurën civile, penale, administrative dhe kundërvajtëse, nëpërmes së cilit sigurohet qasja efektive në drejtësi për qytetarët të cilët nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare.

Fale bashkëpunimit te ANJF-se me UNDP me qellim te shtrirjes se ndihmës juridike ne tere territorin e Republikës se Kosovës, janë hapur 8 zyra ne komuna te ndryshme te Republikës se Kosovës, ne te cilat ofrohet ndihma juridike falas, rreth 40 % te gjitha rasteve.

Fale bashkëpunimit dhe mbështetjes financiare nga UNDP, ANJF ka arritur te avancoj ofrimin e shërbimeve te ndihmës juridike falas, ne shtrirje territoriale ne gjithëpërfshirje dhe ne menaxhim me cilësor te shërbimeve.

Sfide e ANJF-se, është inkorporomi i këtyre 8 zyrave ne buxhetin e Republikës se Kosovës, sepse ne baze te marrëveshjes me UNDP, kjo përkrahje financiare do te jete deri me dt. 30.04.2014, si pasoje e përfundimit te kësaj mbështetje, ANJF do te gjendet ne pamundësi për te vazhduar me kapacitetet ekzistuese me ofrimin e ndihmës juridike falas ne nivelin, te cilin ANJF e ka arritur me përkushtim.

Përkundër këtij fakti, Agjencia për Ndhmë Juridike Falas, qëndron e përkushtuar, në shërbim të të gjithë atyre të cilët i plotësojnë kriteret e përcaktuara me ligj, për ofrimin e ndihmës juridike falas, veçanërisht parimeve të drejtësisë dhe sundimit të ligjit.

Faleminderit për vëmendjen Tuaj si dhe për kohën e kushtuar.

Me respekt

Agjencia për Ndhmë Juridike Falas

1.1. Vizioni

Republika e Kosovës si një shtet demokratik, me Kushtetutën e saj siguron dhe garanton respektimin e të drejtave të njeriut dhe qasjen e barabartë në drejtësi, duke e avancuar sundimin e ligjit.

Duke e integruar sistemin e ndihmës juridike, Agjencia për Ndhmë Juridike Falas do të kontribuojë në: (1) formimin e një kornize të re ligjore dhe institucionale në sistemin e tërësishëm të ndihmës juridike; (2) ofrimin e mundësisë qytetarëve me gjendje të vështirë ekonomike në përfitimin nga shërbimet profesionale falas; (3) forcimin e shtetit ligjor në Kosovë, përmes ngritjes së kulturës juridike të qytetarëve, për shfrytëzimin e rrugëve institucionale, për zgjidhjen e situatave kontestuese, që bëhet e mundur vetëm nëpërmjet qasjes së barabartë e të gjithë qytetarëve në shërbimet e ndihmës juridike.

1.2. Misioni

Agjencia për Ndhmë Juridike Falas mision te vetin ka: ofrimin e ndihmës juridike falas për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, të cilët i plotësojnë kriteret e përcaktuara ligjore, duke ju mundësuar qasjen e barabartë në drejtësi.

Në realizimin e misionit të vet Agjencia për Ndhmë Juridike Falas mbetet e përkushtuar në respektimin e parimit të mos diskriminimit ndaj askujt pa marr parasysh përkatësinë etnike, racore, politike, gjinore apo ndonjë dallim tjetër, parimin e transparencës dhe respektimin e plotë të ligjit dhe konventave ndërkombëtare.

Si rezultat i kësaj Agjencia për Ndhmë Juridike Falas siguronë që ndihma juridiketë jetë efektive, efikase, funksionale, gjithëpërfshirëse dhe e qëndrueshme.

2. AGJENCIA PËR NDIHMË JURIDIKE FALAS

Agjencia për Ndhmë Juridike Falas është institucioni i pavarur publik, i cili funksionin dhe përgjegjësinë e vet e ushtron në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-017 për Ndhmë Juridike Falas, i cili ka hyrë në fuqi në mars të vitit 2012. Ky Ligj rregullon krijimin e një sistemi funksional për ndihmë juridike falas, në procedurën civile, penale, administrative dhe kundërvajtëse, nëpërmes së cilit sigurohet qasja efektive në drejtësi për qytetarët të cilët nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare.

3. KËSHILLI PËR NDIHMË JURIDIKE FALAS

Në bazë të Ligjit për Ndhimë Juridike falas është formuar Këshilli për Ndhimë Juridike Falas (në tekstin e mëtejshëm Këshilli), i cili është kompetent për sigurimin e ndihmës juridike falas.

Këshilli është institucion themelor i cili kryen funksionet e tij në mënyrë të pavarur nga institucionet tjera publike dhe pa udhëzime dhe ndërhyrje nga asnjë person, si dhe ushtron mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të Agjencisë. Kompetencë dhe përgjegjësi themelore e Këshillit është hartimi i politikave dhe rregullave për ofrimin e ndihmës juridike falas që sigurojnë sistem efektiv, gjithëpërfshirës, fleksibil dhe të qëndrueshëm.

3.1. Përbërja e Këshillit për Ndhimë Juridike Falas

Anëtarët e Këshillit janë zgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Kosovës nga radhët e kandidatëve të propozuar nga institucionet e parapara me nenin 11, paragrafi 3 të Ligjit për Ndhimë Juridike Falas.

Këshilli për Ndhimë Juridike Falas përbëhet prej Kryesuesi, Zv. Kryesuesit dhe 5 (pesë) anëtarëve të Këshillit.

Nr.	Emri dhe mbiemri	Pozita	Institucioni
1.	Alban Sutaj	Kryesues	Ministria e Drejtësisë
2.	Shukrije Gashi	Zv. Kryesuese	Rrjeti i Grave të Kosovës
3.	Nenad Stojćetović	Anëtar	Ministria për Komunitete dhe Kthim
4.	Fadil Racaj	Anëtar	Ministria për Punë dhe Mirëqenies Soc.
5.	Bahrije Berisha	Anëtare	Ministria e Financave
6.	Afrim Shala	Anëtar	Gjykata Supreme
7.	Armend Krasniqi	Anëtarë	Oda e Avokateve të Kosovës

4. AKTIVITETET E KËSHILLIT PËR NDIHMË JURIDIKE FALAS

Këshilli për Ndhimë Juridike Falas gjate vitit 2013 ka mbajtur gjithsej 16 takime, ne kuadër te këtyre takimeve janë nxjerr 12 vendime. Ne këtë periudhe raportuese Këshilli ka miratuar 6 rregullore.

1. Rregullorja ANJF -2013/01 e Punës se Këshillit për Ndhimë Juridike Falas
2. Rregullorja ANJF -2013/02 për Procedurat e Punës se Komisionit për Ankesa
3. Rregullorja ANJF -2013/03 për Përcaktimin e Kualifikimit për Zytaret e ZRNJF-së
4. Rregullorja ANJF -2013/04 për Angazhimin e Avokateve
5. Rregullorja ANJF -2013/05 për Përcaktimin e Kriteve për Ofrimin e Ndhimës Juridike Falas nga OJQ-të
6. Rregullorja ANJF -2013/06 për Organizimin e Brendshëm Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë për Ndhimë Juridike Falas

Këshilli për Ndhimë Juridike Falas ne vazhdimësinë e aktiviteteve te cilat i ka zhvilluar ne kontinuitet, ka realizuar një varg takime te rëndësishme me përfaqësues te institucioneve vendore dhe ndërkombëtare.

5. ZYRA E DREJTORIT EKZEKUTIV (ZDE)

Zyra e Drejtorit Ekzekutiv është zyre qendrore në sistemin e ndihmës juridike falas. Është përgjegjëse për administrimin e sistemit të ndihmës juridike, mbikëqyrjen e zyrave rajonale për ndihmë juridike falas, mbikëqyrjen e punës për të gjithë të punësuarit në ANJF.

Bashkëpunon me të gjitha institucionet, organizatat vendore dhe ndërkombëtare, me qëllim të avancimit të ofrimit të ndihmës juridike falas.

Zyra e Drejtorit Ekzekutiv (ZDE) në kontinuitet ka zhvilluar aktivitetet e veta dhe i është përmbajtur procedurave standarde të veprimit te përcaktuara në Ligjin Nr.04/L-017 për Ndhimë Juridike Falas, duke i ofruar ndihmë juridike te drejtpërdrejtë, qytetareve të Republikës se Kosovës me gjendje te vështire ekonomike, dhe njëkohësisht duke siguruar se ndihma juridike e ofruar është e efektshme, efikase, gjithëpërfshirëse, fleksibile dhe e qëndrueshme. Në këtë mënyrë qytetarëve që i plotësojnë kriteret e përcaktuara më ligj, u është mundësuar qasja e barabartë në drejtësi.

ANJF është përkujdesur që në emër të drejtësisë, te të gjithë siguresit e ndihmës juridike të krijohet vetëdija e mbrojtjes së interesave për të gjithë qytetarët, të cilëve për shkak të mungesës së mjeteve materiale i është mohuar qasja e barabartë në drejtësi, sidomos grupeve të

cenueshme (fëmijëve, pakicave, viktimave të dhunës familjare, të moshuarave, personave me aftësi të kufizuara, të zhvendosurave etj) përmes ofrimit të ndihmës juridike falas.

5.1. Aktivitetet e Zyrës së Drejtorit Ekzekutiv

ZDE-ja ka arritur të ofrojë dhe në përgjithësi të sigurojë shërbime administrative, teknike, si dhe shërbime tjera mbështetëse për ANJF-në, duke realizuar menaxhimin efektiv dhe efikas të punëve. Gjithashtu, në drejtim të arritjes së objektivave specifike të punës, ka koordinuar, ka mbikëqyrur dhe ka përcjellë punën e Zyrës së Administratës Qendrore, Zyrës së Personelit, të Prokurimit, Teknologjisë Informative dhe Arkivin.

Angazhimi i ZDE-së ka qenë i drejtuar vazhdimisht në ofrimin e përkrahjes administrative dhe funksionimit të rregullt të takimeve të Këshillit për Ndihmë Juridike Falas, duke i zbatuar të gjitha vendimet e nxjerra nga Këshilli.

ZDE ka qenë bartëse e organizimit të promovimit për tri zyra për ndihmë juridike falas, të cilat kanë filluar të veprojnë që nga janari i vitit 2013, në Skenderaj, Klinë dhe Klllokot. Gjithashtu ZDE ka qenë bartëse e jetësimit, trajnimit dhe promovimit të data bazës, një aktivitet shumë i rëndësishëm për menaxhimin dhe monitorimin e kapaciteteve të raportimit dhe evidentimit të rasteve, aktivitete të mbështetura nga Projekti “Avancimi i Drejtësisë Gjinore” - UNDP

Duke u mbështetur në LNJF-në, që ndihma juridike falas shtrihet në tërë territorin e Kosovës, dhe duke ditur se ANJF me 13 zyra për ofrimin e ndihmës juridike falas nuk mund të mbulojë kërkesat e qytetarëve, në komunat në të cilat nuk i ka të hapur zyrat për ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike falas, sidomos grupeve të cenueshme, me Projektin “Avancimi i Drejtësisë Gjinore” i mbështetur nga UNDP, kemi formuar Klinikën mobile lëvizëse, një aktivitet jashtëzakonisht i rëndësishëm, pikërisht për arsye të cekura më lartë.

Jetësimi i klinikës mobile për ndihmë juridike falas ka mundësuar jo vetëm qasjen e barabartë në drejtësi, por ka luajtur rolin kyç në realizimin e të drejtave të cenuara të qytetarëve, në komunat: Obiliq, F. Kosovë, Podujevë, Kamenicë, Rahovec dhe vendbanimet e komunës së Dragashit (Restelicë dhe Bresanë).

Për këtë aktivitet të ANJF, donatorët mbështetës të UNDP-së kanë qenë: UNKT, United Nations Trust Fund for Human Security, Mbretëria e Holandës dhe Ambasada e Finlandës.

ZDE-janë mbështetje te UNDP ka organizuar “Javën e Ndhmës Juridike Falas” si fushatë vetëdijesuese qëllimi i se cilës ka qenë informimi dhe vetëdijesimi i qytetarëve lidhur me shërbimet e ofruara nga Agjencia për Ndhmë Juridike Falas

Fushata vetëdijesuese është mbajtur paralelisht në 10 komuna të Republikës së Kosovës, si: Prishtinë, Pejë, Gjiilan, Mitrovicë, Ferizaj, Gjakovë, Dragash, Skenderaj Klllokot, dhe Klinë.

Ne dakordim me UNDP, gjate kësaj fushate janë angazhuar student te cilët kane asistuar gjate kohës se fushatës. Angazhimi i studenteve është bere përmes Qendrës për Zhvillimin e Karrierës ne Fakultetin Juridik.

Gjate kohës së fushatës konsiderohet se është arritur një vetëdijesim i qytetarëve, për shërbimet te cilat ofron Agjencia për Ndhmë Juridike Falas, numri i qytetarëve të evidentuar në lista është 2.605 qytetarë, kurse numri i qytetareve te cilët kanë përfituar ndihme juridike falas, si rezultat i fushatës një javore është afër 200 përfitues.

Gjate kësaj periudhe raportuese në komunat Gjilan, Dragash dhe Gjakovë është themeluar mekanizmi koordinues kundër dhunës në familje dhe mënyrën e institucionalizimit të tij. Pjese e këtij mekanizmi ka qene edhe ANJF, me ç’rast është edhe pjese e nënshkrimit te Marrëveshjes se Mirëkuptimit. Marrëveshja konsiston bashkëpunimin e institucioneve: Komuna, Prokuroria, Gjykata Komunale, Strehimore e viktimave të dhunës në familje, Qendra për Punës Sociale, Policia-Njësi kundër dhunës në familje dhe ANJF.

5.1.1. Mësimi praktik

Në drejtim të realizimit të Marrëveshjes së ANJF-së me Universitetin e Prishtinës (UP) Fakultetin Juridik, ANJF-ja ju ka mundësuar studentëve që janë përzgjedhur nga Fakulteti Juridik, të vijojnë punën praktike në zyrat rajonale për ndihmë juridike falas.

ANJF-ja ju ka mundësuar edhe studentëve vullnetarë që të kryejnë punën praktike në këtë institucion.

5.1.2. Takimet e rëndësishme

Me qëllim të sensibilizimit dhe promovimit të punës të ANJF-së, janë mbajtur një varg takimesh me institucionet vendore dhe ndërkombëtare, ndër më të rëndësishmet ka qenë takimi me përfaqësues te Kuvendit te Republikës se Kosovës, përfaqësues te ministrive, përfaqësues te komunave konkretisht ne komunat ku vepron ANJF, përfaqësues te Avokatit te Popullit, OAK, UNDP, OSCE, UNICEF, përfaqësues te shoqërisë civile etj.

5.1.3. Zyra e Administratës Qendrore

Merret me aktivitetet e shërbimeve administrative dhe mbikëqyret nga Drejtori Ekzekutiv.

5.1.4. Burime Njerëzore

Burimet njerëzore vazhdojnë dhe mbesin aktivitetet të rëndësishmenëketëinstitucion.

ANJF-ja në vitin raportues ka rekrutuar 2 pozita ne Shërbimin Civil dhe 3 pozita te cilat janë përkrahur nga Projekti UNDP. Procedurat e rekrutimit janë zhvilluar në pajtim me Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës nr. 03/L-149.


Momentalisht stafi i ANJF-së numëron gjithsej 50 të punësuar, prej të cilëve 22 janë shërbyes civil, ndërsa 28 nga projekti i UNDP-së.

Nga numri total i të punësuarve ne cilësinë e shërbyesve civil 11 janë femra dhe 11 meshkuj, ndërsa nga te punësuarit nga Projektit UNDP 13 janë femra dhe 15 meshkuj.

Prej gjithsej 50 te punësuarve të komunitetit shqiptar janë 42, te komunitetit serb janë 4 , të komunitetit boshnjak j 2, të komunitetit turk 1dhe 1 komunitetit ashkali.




Gjatë periudhës raportuese marrëdhënien e punës e kanë ndërprerë 2 të punësuar. Prej tyre një Zyrtar për Ndihmë Juridike ne ZRNJ – Prizren dhe një Zyrtar i Prokurimit.

5.1. *Struktura organizative e agjencisë për ndihmë juridike FALAS*



Zyrat Për Ndhimë Juridike Falas Nga Projekti " Qasjenë Drejtësi "- UNDP

Zyrat Për Ndhimë Juridike Falas Nga Projekti " Avancimi i Drejtësisë Gjinore "- UNDP



Grafikonet paraqesin strukturën gjinore dhe etnike të personelit në ANJF

5.1.5. Trajnimet

Në periudhën raportuese Zyra e Personelit vazhdimisht ka zbatuar ngritjen profesionale të stafit, nëpërmjet trajnimeve të ndryshme. Duke i ndjekur trajnimet me sukses, stafi ka përfunduar dhe është certifikuar, nga institucionet e specializuara: Instituti i Administratës Publike i Kosovës (IKAP); UNDP-ja, OSCE-ja, etj. Gjatë këtij viti raportues, ngritjen profesionale të stafit e ka përkrahur edhe vet ANJF-ja.

5.1.6. Buxheti dhe financat

Shërbimi i financave është përgjegjës për realizimin e buxhetit dhe zhvillimin e procedurave financiare.

Gjatë vitit 2013, nga buxheti i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, Agjencia për Ndihmë Juridike Falas ka realizuar 96,66 % të buxhetit të paraparë.


Buxheti për vitin 2013 për Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas, ka qenë 292,354.00 €.

Më poshtë në mënyrë tabelore paraqesim strukturën e buxhetit sipas kategorive ekonomike


Përshkrim i	Buxheti miratuar	Buxhetti Alokuar	Mjetet e pa alokuara	Zotimetë pashlyera	Mjetet e shfrytëzuara	Mjetet e pa shfrytëzuara	Mjetet e shfrytëzuaran %	Mjetet e pa shfrytëzuara Në%
Pagat	127,455.00	123,781.87	3,673.13	0.00	123,781.87	3,673.13	97.11	2.88
Mallrat dëshërbimet	148,870.00	148,870.00	0.00	1,895.63	146,868.52	2,000.98	98.65	1.34
Shpenzimet komunale	16,020.00	16,020.00	0.00	0.00	11,958.43	4,061.57	74.64	25.35
Totali	292,345.00	288,671.87	3,673.13	1,895.63	282,608.82	9,736.18	96.66	3.33

janar dhjetor 2013

Paraqitja grafike e Buxhetit për periudhën Janar – Dhjetor 2013



Paraqitja grafike e Realizimit të Buxhetit 2013



5.1.7. Prokurimi

Në fillim të vitit raportues zyra e Prokurimit pranë ANJF-së ka dorëzuar planifikimin e prokurimit, në Agjencinë e Prokurimit Publik. Kjo zyre ka zhvilluar disa procedurave të prokurimit publik. Prokurimi i ANJF-së ka iniciuar 14 aktivitete të prokurimit.

Procedura e kuotimit të çmimit.

Janë nënshkruar 6 (gjashtë) kontrata

1. Furnizim me materia higjenik,
2. Përkthimi i materialeve
3. Furnizim me karburante,
4. Sigurimi fizik i objektit
5. Mirëmbajtja dhe servisimi i automjeteve
6. Mirëmbajtja dhe pastrimi

- ***Procedurat me vlerë minimale.***

Janë nënshkruar 8(tetë) kontrata

1. Furnizim me mobile për nevojat e ANJF
2. Publikimi i njoftimeve
3. Sigurimi i Klinikës Mobile
4. Punimi i vulave
5. Sigurimi i auto-veturave
6. Sistemi i alarmit
7. Furnizim me kasa për vendosjen e vulave
8. Blerja e LAP Top -i

5.1.8. Teknologji Informative


Shërbimi i teknologjisë informative është mirëmbajtur nga zyrtari i IT-së në bashkëpunim me shërbimet kompetente të MAP –it. Shërbimi i teknologjisë informative është përkujdesur për mirëmbajtjen e ueb faqes së ANJF-së, e cila në vazhdimësi freskohet me të dhënat e nevojshme të aktiviteteve të ANJF-së. Gjatë vitit 2013 është instaluar dhe konfiguruar programi ibazës se të dhënave të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas.

5.1.9. Arkiva

Gjatë vitit 2013 në ANJF janë pranuar, regjistruar, protokolluar dhe arkivuar shumë shkresa si për komunikim të brendshëm, për komunikim të jashtëm, si dhe lëndë të avokatëve, si në vijim:

- Shkresa të dërguara 154
- Shkresa të pranuar, 64
- Shkresa në komunikim të brendshëm 71
- Lëndët e regjistruara të avokatëve 723

Përveç këtyre janë regjistruar edhe dokumente tjera, ashtu që në ANJF janë të arkivuara gjithsej 1433 shkresa.



5.1.10. *Auditimi*

Agjencia për Ndhmë Juridike Falas menaxhon në mënyrë të pavarur buxhetin e saj, Në këtë vit raportues Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) ka audituar punën në Agjencinë për Ndhmë Juridike Falas, për nëntë muaj. Pas auditimit, në afat ligjor ZAP-i i ka dërguar ANJF-së raportin e auditimit.

5.2. Zyrat rajonale për ndihmë juridike falas

Aktualisht ofrimi i ndihmës juridike shtrihet në tërë territorin e Republikës së Kosovës, nëpërmjet zyrave rajonale për ndihmë juridike falas, në 5 (pesë) rajone: Prishtinë, Prizren, Pejë, Mitrovicë dhe Gjiilan, dhe 8 zyra për ndihmë juridike të përkrahura nga Projekti “Avancimi i Drejtësisë Gjimore” - UNDP, në: Graçanicë, Ferizaj, Dragash, Gjakovë, Mitrovicë, Kllklot, Skenderaj dhe në Klinë.

Harta me Zyrat për Ndhmë Juridike Falas në Republikën e Kosovës



Në zyrat për ndihmë juridike falas, në mënyrë të drejtpërdrejtë i ofrohet ndihma juridike falas, në lëmin civile, administrative, penale dhe kundërvajtëse, të gjithë qytetarëve me gjendje të vështirë materiale të cilët i plotësojnë kriteret e përcaktuara në Ligjin për Ndhmë Juridike Falas.

5.2.1. Kompetencat dhe përgjegjësitë e ZRNJF-ve

1. Vendosin mbi kërkesat për ndihmë juridike, ashtu siç parasheh Ligji për Ndhmë Juridike Falas;
2. Ofrojnë ndihmë juridike duke:
 - a) Ndhmuar aplikuesit për plotësimin e kërkesës
 - b) Kompletuar dokumentet e nevojshme për plotësimin e kërkesës

- c) Vërtetuar informatat lidhur me dokumentet e ofruara
3. Vendosin mbi të drejtën e kërkuesit në përfitimin e ndihmës juridike;
 4. Në bazë të gjendjes financiare të kërkuesit vendosin për ofrimin e ndihmës juridike primare, apo sekondare;
 5. Vendosin mbi besueshmërinë e rastit;
 6. Vendosin nëse ndihma e kërkuar është brenda fushës së shërbimeve të ndihmës juridike;
 7. Pranojnë ankesa kundër vendimit mbi refuzimin e ndihmës juridike, duke raportuar Zyrën e Drejtorit Ekzekutiv për Ndhmë Juridike;
 8. Angazhojnë avokatë prej listës së ofruar nga Oda e Avokatëve të Kosovës;
 9. Gjatë angazhimit të avokatëve nga lista e avokatëve, kujdesen për angazhimin e barabartë të tyre në ofrimin e ndihmës juridike, duke respektuar përvojën dhe lëmin e tyre.

5.1.1. Zyra Rajonale për Ndhmë Juridike Falas (ZRNJF) - P r i s h t i n ë

Rajoni i Prishtinës numëron dymbëdhjetë komuna: Prishtinë, Ferizaj, Podujevë, Lipjan, Drenas, Kaçanik, Hani i Elezit, Fushë Kosovë, Shtime, Kastriot (Obiliq), Shtërpçë dhe Graçanicë.

Në rajonin e Prishtinës ekzistojnë tri zyre për ofrimin e ndihmës juridike falas : Një ZRNJF në Prishtinë, e cila financohet nga Buxheti i Republikës së Kosovës, edhe dy zyra për ndihmë juridike (ZNJ), në: Graçanicë dhe Ferizaj, të cilat financohen nga UNDP, me Projektin “Avancimi i Drejtësisë Gjimore”.

Në tabelën më poshtë është pasqyruar numri i lëndëve sipas lëmisë, strukturës gjimore dhe përkatësisë etnike të përfitueseve të ndihmës juridike falas, në rajonin e Prishtinës, që përfshinë Zyra Rajonale për Ndhmë Juridike Falas (ZRNJF-ja) në Prishtinë dhe Zyrat për Ndhmë Juridike (ZNJ-të) në Ferizaj dhe Graçanicë.

Komuna e Prishtinës mbulon 49 vendbanime

ZRNJF	Lëmia				Gjinia		Përkatësia etnike									Nr. i lëndëve
	Adm.	Civile	Kunder.	Penale	F	M	Shqip	Serb	Bosh	Tur	Rom	Ashk	Egj	Gor	Tj.	
Prishtinë	175	312	2	46	204	331	517	3	3	3	1	7	0	1	0	535

Periudhë janar-dhjetor 2013

**AGJENCIA PËR NDIHMË JURIDIKE FALAS
AGENCIAJA ZA BESPLATNU PRAVNU POMOË**

Komuna e Ferizajt mbulon 63 vendbanime

ZRNJF	Lëmia				Gjinia		Përkatësia etnike										Nr. i lëndëve
	Adm.	Civile	Kunder.	Penale	F	M	Shqip	Serb	Bosh	Tur	Rom	Ashk	Egj	Gor	Tj.		
Ferizaj	453	294	3	71	246	575	726	1	1	0	4	86	0	0	3	821	

Periudhë janar-dhjetor-2013

Komuna e Graçanicës

ZRNJF	Lëmia				Gjinia		Përkatësia etnike										Nr. i lëndëve
	Adm.	Civile	Kunder.	Penale	F	M	Shqip	Serb	Bosh	Tur	Rom	Ashk	Egj	Gor	Tj.		
Graçanicë	106	124	0	3	82	151	31	173	0	0	19	1	0	1	7	233	

Periudhë janar-dhjetor-2013

5.1.2. Zyra për Ndhimë Juridike Falas (ZRNJF) - P r i z r e n

Rajoni i Prizren numëron 6 komuna: Prizren, Therandë (Suharekë), Rahovec, Malishevë, Dragash dhe Mamushë.

Në rajonin e Prizrenit ekzistojnë dy zyre për ofrimin e ndihmës juridike falas : Një ZRNJF në Prizren, e cila financohet nga Buxheti i Kosovës, dhe një ZNJ në Dragash, e cila financohen nga UNDP, me Projektin “Avancimi i Drejtësisë Gjimore”

Në tabelë më poshtë është pasqyruar numri i lëndëve sipas lëmisë, strukturës gjimore dhe përkatësisë etnike të përfitueseve të ndihmës juridike falas, në regjionin e Prizrenit , që përfshinë : ZRNJF Prizren dhe ZNJ Dragash

Komuna e Prizrenit mbulon 76 vendbanime

ZRNJF	Lëmia				Gjinia		Përkatësia etnike										Nr. i lëndëve
	Adm.	Civile	Kunder.	Penale	F	M	Shqip	Serb	Bosh	Tur	Rom	Ashk	Egj	Gor	Tj.		
Prizren	328	295	2	30	202	453	454	0	64	42	78	12	0	4	1	655	

Periudhë janar-dhjetor 2013

Komuna e Dragashit mbulon 36 vendbanime

ZRNJF	Lëmia				Gjinia		Përkatësia etnike										Nr. i lëndëve
	Adm.	Civile	Kunder.	Penale	F	M	Shqip	Serb	Bosh	Tur	Rom	Ashk	Egj	Gor	Tj.		
Dragash	144	107	0	14	35	230	211	0	1	0	0	0	0	53	0	265	

Periudhë janar-dhjetor 2013

5.1.3. Zyra për Ndhimë Juridike Falas (ZRNJF) - P e j ë

Rajoni i Pejës numëron 6 komuna: Pejë, Gjakovë, Klinë, Deçan, Istog dhe Junik

Në rajonin e Pejës ekzistojnë dy zyre për ofrimin e ndihmës juridike falas: Një ZRNJF në Pejë, e cila financohet nga Buxheti i Kosovës, një ZNJ në Gjakovë dhe një ZNJ në Klinë të cilat financohen nga UNDP, me Projektin “Avancimi i Drejtësisë Gjimore”.

Në tabelë më poshtë është pasqyruar numri i lëndëve sipas lëmisë, strukturës gjimore dhe përkatësisë etnike të përfitueseve të ndihmës juridike falas, në regjionin e Pejës, që përfshin: ZRNJF Pejë dhe ZNJ Gjakovë.

Komuna e Pejës mbulon 79 vendbanime.

ZRNJF	Lëmia				Gjinia		Përkatësia etnike								Nr. i lëndëve	
	Adm.	Civile	Kunder.	Penale	F	M	Shqip	Serb	Bosh	Tur	Rom	Ashk	Egj	Gor		Tj.
Pejë	238	146	0	23	120	287	289	1	23	2	34	5	0	53	2	407

Periudhë janar-dhjetor 2013

Komuna e Gjakovës numëron 88 vendbanime

ZRNJF	Lëmia				Gjinia		Përkatësia etnike								Nr. i lëndëve	
	Adm.	Civile	Kunder.	Penale	F	M	Shqip	Serb	Bosh	Tur	Rom	Ashk	Egj	Gor		Tj.
Gjakovë	265	138	0	20	180	243	346	0	1	0	11	21	43	0	1	423

Periudhë janar-dhjetor 2013

Komuna e Klinës numëron 54 vendbanime

ZRNJF	Lëmia				Gjinia		Përkatësia etnike								Nr. i lëndëve	
	Adm.	Civile	Kunder.	Penale	F	M	Shqip	Serb	Bosh	Tur	Rom	Ashk	Egj	Gor		Tj.
Klinë	209	117	4	11	60	281	311	2	0	0	6	0	22	0	0	341

Periudhë janar-dhjetor 2013

5.1.4. Zyra për Ndhmë Juridike Falas (ZRNJF) – Mitrovicë

Rajoni i Mitrovicë, numëron 6 komuna: Mitrovicë, Vushtrri, Skenderaj, Leposaviq, Zveçan dhe Zubin Potok

Në rajonin e Mitrovicës ekzistojnë dy zyre për ofrimin e ndihmës juridike falas: Një ZRNJF në Mitrovicë, e cila financohet nga Buxheti i Kosovës, një ZNJ në pjesën veriore të Mitrovicës dhe një ZNJ në Skenderaj të cilat financohen nga UNDP, me Projektin “Avancimi i Drejtësisë Gjimore”

Komuna e Mitrovicës mbulon 47 vendbanime

ZRNJF	Lëmia				Gjinia		Përkatësia etnike									Nr. i lëndëve
	Adm.	Civile	Kunder.	Penale	F	M	Shqip	Serb	Bosh	Tur	Rom	Ashk	Egj	Gor	Tj.	
Mitrovicë	332	158	0	1	113	378	475	1	2	0	1	10	0	0	2	491

Periudhë janar-dhjetor 2013

Zyra në Mitrovicën Veriore– UNDP

ZRNJF	Lëmia				Gjinia		Përkatësia etnike									Nr. i lëndëve
	Adm.	Civile	Kunder.	Penale	F	M	Shqip	Serb	Bosh	Tur	Rom	Ashk	Egj	Gor	Tj.	
Mit. Veri	94	10	0	0	60	44	4	83	3	0	14	0	0	0	0	104

Periudhë janar-dhjetor 2013

Zyra në Skenderaj – UNDP

ZRNJF	Lëmia				Gjinia		Përkatësia etnike									Nr. i lëndëve
	Adm.	Civile	Kunder.	Penale	F	M	Shqip	Serb	Bosh	Tur	Rom	Ashk	Egj	Gor	Tj.	
Skenderaj	325	111	0	1	84	353	433	3	1	0	0	0	0	0	0	437

Periudhë janar-dhjetor 2013

5.1.5. Zyra për Ndhmë Juridike Falas (ZRNJF) – Gjilan

Rajoni i Gjilanit numëron 8 komuna: Gjilan, Dardan (Kamenicë), Viti, Artan (Novobërdë), Kllokot, Ranilligë dhe Partesh.

**AGJENCIA PËR NDIHMË JURIDIKE FALAS
AGENCIJA ZA BESPLATNU PRAVNU POMOË**

Në rajonin e Gjilanit ekzistojnë dy zyre për ofrimin e ndihmës juridike falas: Një ZRNJF në Gjilan, e cila financohet nga Buxheti i Kosovës, dhe një ZNJ në Kllokot, e cila financohet nga UNDP-ja, me Projektin “Avancimi i Drejtësisë Gjimore”.

Komuna e Gjilanit numëron 63 vendbanime

ZRNJF	Lëmia				Gjinia		Përkatësia etnike									Nr. i lëndëve	
Gjilan	Adm.	Civile	Kunder.	Penale	F	M	Shqip	Serb	Bosh	Tur	Rom	Ashk	Egj	Gor	Tj.		
	431	253	2	52	253	485	702	10	2	3	20	0	0	0	0	3	738

Periudhë janar-dhjetor 2013


Komuna e Kllokotit numëron 4 vendbanime

ZRNJF	Lëmia				Gjinia		Përkatësia etnike									Nr. i lëndëve	
Kllokot	Adm.	Civile	Kunder.	Penale	F	M	Shqip	Serb	Bosh	Tur	Rom	Ashk	Egj	Gor	Tj.		
	52	44	1	14	24	87	73	37	1	0	0	0	0	0	0	0	111


Periudhë janar-dhjetor 2013

Totali i lendeve për vitin 2013

2012	Lëmia				Gjinia		Përkatësia etnike									Nr. i lëndëve
	Adm.	Civ	Kund	Pen.	F	M	Shq.	Serb	Bosh.	Tur.	Rom	Ashk.	Egjip.	Etj		
	3,206	2,168	15	297	1685	4001	4684	325	102	45	193	142	65	130	5686	



Pasqyra e numrit të lëndëve sipas lëmime, periudha janar-dhjetor 2013



Paraqitja e përfituesve të ndihmës juridike sipas përkatësisë etnike dhe gjinore 2012

5.4. Bashkëpunimi ndërkombëtar


Gjatë këtij viti raportues Agjencia për Ndhimë Juridike Falas ka realizuar bashkëpunim ndërkombëtar, me pjesëmarrje, takime të ndryshme, dhe realizimin e komponentëve të mbështetura nga UNDP-ja, OSCE-ja. Si aktivitete të bashkëpunimit ndërkombëtar mund të veçojmë:

- Takime pune me përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë në R.SH
- Takim pune me Avokatin e Popullit, të RSH
- Vizite zyrtare Republikës së Kroacisë, takim me Institucionin e Avokatit të Popullit, Ministrinë e Drejtësisë, Oden e Avokateve të Republikës së Kroacisë
- UNDP- implementimi i Projektit
- OSCE- përkrahja e trajnimeve për stafin e ANJF-së.

5.5. Bashkëpunimi i Agjencisë për ndihmë juridike falas me odën e avokatëve (OAK)

ANJF-a vazhdon të bashkëpunojë me Odën e Avokatëve të Kosovës në përcaktimin e masave pozitive për të siguruar përfaqësim të drejtë të përfituesve ashtu edhe të ofruesve të ndihmës juridike.

Në periudhën raportuese për vitin 2013, janë angazhuar 370 (treqind e shtatëdhjetë) avokatë.



5.6. Donatorët

Agjencia për Ndhmë Juridike Falas ka pasur asistencë të konsiderueshme sidomos nga UNDP-ja, realizimi i Projektit “Avancimi i Drejtësisë Gjimore” të cilët kanë mbështetur Agjencinë për Ndhmë Juridike Falas në disa komponentë gjatë tërë vitit 2013, dhe vazhdon edhe më tutje. ANJF-ja ka pasur mbështetje edhe nga OSCE-ja në ngritjen e kapaciteteve profesionale për stafin e ANJF-së, në organizimin e trajnimeve.

5.7. Mangësitë dhe sfidat në sistemin e ndihmës juridike

Duke i analizuar aktivitetet në drejtim të ofrimit të ndihmës juridike falas, e cila ju mundësohet personave që nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare, janë arritur rezultate të kënaqshme. Përkundër këtij fakti, sistemin e ndihmës juridike që nga themelimi e deri më sot e kanë përcjellë disa mangësi dhe sfida të ndryshme.

5.8. Mangësitë në Sistemin e Ndhmës Juridike

Ndër mangësitë kryesore të sistemit të Ndihmës Juridike janë mungesa e mjeteve financiare në buxhetin e ANJF-së, e cila ka rezultuar në:

- Angazhimin e kufizuar të avokatëve,
- Sensibilizimin e pamjaftueshëm të opinionit publik,
- Numrin e pamjaftueshëm të personelit profesional,
- Trajnimin e pamjaftueshëm për ngritjen e aftësive profesionale.

5.9. Sfidat në Sistemin e Ndihmës Juridike

Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas, si institucion të ri, e kanë përcjellë një varg pengesash, mangësi dhe lloje të ndryshme të sfidave.

Që nga themelimi e deri më sot, sfidat kryesore për funksionalizimin e një sistemi kualitativ të Ndihmës Juridike në Republikën e Kosovës janë:

1. Sigurimi i buxhetit të qëndrueshëm për të plotësuar nevojat e palëve në sistemin e gjithmbarshëm të Ndihmës Juridike në Republikën e Kosovës.
2. Inkorporimi i 8 (tetë) zyrave për ndihmë juridike nga Projekti “Avancimi i Drejtësisë Gjimore”, në Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas si zyre të rregullta për ofrimin e ndihmës juridike.
3. Ndërtimi i kapaciteteve profesionale dhe administrative, në institucionet e sistemit të Ndihmës Juridike.
4. Sensibilizimi dhe vetëdijesimi i publikut, veçmas i grupeve të interesit, interesi i të cilëve ndërlidhet me ndihmën juridike.
5. Avancimi i bashkëpunimit ndërinstitutional në mes institucionit të Ndihmës Juridike dhe institucioneve të nivelit qendror në Republikën e Kosovës, veçmas me institucionet e drejtësisë në vendin tonë.
6. Hulimtimi dhe gjetja e burimeve financiare nga donatorët e ndryshëm.
7. Shtrirja e drejtë dhe e barabartë e sistemit të përgjithshëm të Ndihmës Juridike, në të gjitha ne te gjitha regjionet, përkatësisht në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës.
8. Edukimi dhe arsimimi i vazhdueshëm kualitativ i personelit të Ndihmës Juridike në Republikën e Kosovës.

Për përmbushjen e sfidave, evitimin dhe eliminimin e pengesave, si dhe mangësive të natyrave të ndryshme, Agjencia për Ndhmë Juridike Falas, duke synuar një sistem të ligjshëm dhe të mirëfilltë të Ndhmës Juridike propozon këto:

6. REKOMANDIME

1. Rritja e buxhetit për Agjencinë për Ndhmë Juridike Falas, në përputhje me kërkesat e qytetarëve të cilët kërkojnë ndihmë juridike falas në Republikën e Kosovës.
2. Inkorporimi i 8 (tetë) zyrave për ndihmë juridike nga Projekti “Avancimi i Drejtësisë Gjimore”, në Agjencinë për Ndhmë Juridike Falas si zyre të rregullta për ofrimin e ndihmës juridike.
3. Sensibilizimi i vazhdueshëm i institucioneve dhe organeve të Republikës së Kosovës për rëndësinë që duhet kushtuar këtij institucioni.
4. Edukimi dhe ngritja e vetëdijes së qytetarëve për rolin dhe mundësitë që u ofron ANJF-ja.
5. Ngritja e vazhdueshme profesionale e stafit të ANJF-se, për shfrytëzimin e të gjithë mekanizmave ekzistues ligjor për ndihmë juridike.